



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 29

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

Prishtinë, më 20 prill 2016, në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka dhe Hatim Baxhaku.

Munguan: Adem Hoxha, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati –NDI, Kenan Gashi – AVONET, Fjolla Uka- KDI, Amire Qamili –BIRN, Hatmane Goli –IKPZH dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim para komisionit, vizita zyrtare në Turqi;
3. Raportimi i ekspertit për përgatitjen e dokumenteve për nismën ligjore, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 / L - 054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre;
4. Plani i veprimit për monitorimin e Ligjit për Shëndetësi;
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Raportim para komisionit, vizita zyrtare në Turqi;

Kryetarja, tha se para jush po paraqesim një raport të shkurtër para komisionit për vizitën zyrtare në Turqi që kemi realizuar prej datës 10 - 14 Prill 2016, pasi që për këtë vizitë do të përgatisim edhe raportin e zgjeruar me shkrim ku do të njoftojmë Kryesinë e Kuvendit lidhur me vizitën. Realizimin e kësaj vizite e ka mbështetur Kuvendi i Kosovës si dhe Agjencia Turke për Bashkepunim dhe Zhvillim (TIKA), ne si grup që kemi marrë pjesë në këtë vizitë e kemi vlerësuar shumë frytëdhënëse këtë vizitë ku kemi pasur mundësi të njoftohemi nga afër rreth organizimit dhe funksionimit të shërbimit emergjent prej strukturës menaxhuese deri të niveli bazë stacionet e ofrimit të shërbimeve emergjente. Këtë përvojë unë e kam vlerësuar si nga përvojat me të rëndësishme, ku na është dhënë mundësia që në çdo nivel të shohim nga afër organizmin dhe funksionimit të shërbimit mjekësor emergjent si dhe të diskutojmë hapur praktikatat e një shteti i cili ka arritur në nivel shumë të lartë të mbrojtjes shëndetësore. Në kuadër të kësaj vizite kemi realizuar disa takime dhe vizita nëpër institucione shëndetësore-emergjence, duke filluar nga takimi me Këshilltarin e parë të Presidentit të Turqisë z. Erdogan, takim me Ministrin e Shëndetësisë, takim me drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë Turke për Bashkepunim dhe Zhvillim (TIKA), takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave, takim me kryetarin e komisionit homolog të Kuvendit të Turqisë, takim me grupin e miqësisë Kosovë –Turqi, takim me drejtorin e përgjithshëm të drejtorisë së shërbimeve shëndetësore, vizitë qendrës kryesore të emergjencave në nivel vendi, qendrës së emergjencave në regjionin e Ankarasë si dhe vizita në strukturat apo stacionet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore –emergjente. Po thuajse në të gjitha takimet kemi marrë mbështetje shumë të madhe sa i përket thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe me theks të veçantë përkrahjes në sektorin e shëndetësisë qoftë me aftësimin e kuadrove, pajisjes me aparatura, si dhe ndërtimit të qendrës rajonale për trajnimin e stafit apo ekipeve për kërkim shpëtim Qendër për trajnimin e stafit. Po ashtu na ofruan përkrahjen e përgatitjes së projekteve bashkërisht për aplikim në fondet e Bashkimit Evropian për financimin apo mbështetjen financiare të sektorit të shëndetësisë në Kosovë. Shpresojmë se këtë mbështetje do të konkretizojmë në të ardhmen midis dy vendeve, po ashtu besoj se bashkërisht praktikatat që i kemi marrë gjatë kësaj vizite dhe vizitave në regjion lidhur me funksionimin e shërbimeve mjekësore emergjente do të inkorporojmë në legjisllacionin tonë konkretisht në projektligjin të cilin e kemi në procedurë për shërbimin mjekësor emergjent. Po ashtu siç jemi dakorduar ne do të realizojmë edhe disa takime dhe vizita në teren ku nga afër do të shohim se si funksionon shërbimi emergjent pra në kuadër të FSK-së, Agjencisë për menaxhimin e Emergjencave –MPB. Po ashtu do të realizojmë një Takim me Kryeministrin se bashku me Ministrin e Shëndetësisë lidhur me këtë projektligj dhe ndryshimet që do të ndodhin në të. A dëshiron dikush të shtoj me tepër rreth vizitës, urdhëroni z. Baxhaku.

Hatim Baxhaku – faleminderit kryetare. Të nderuar deputet. Vizitën që e kemi realizuar në Turqi unë konsideroj se ka qenë shumë e suksesshme pasi që dilemat që i kemi pasur ne si dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë rreth organizimit të shërbimeve emergjente, pra ashtu siç parashihet me projektligjin që e kemi në amendamentim ishte i pa mundur që të organizohet një shërbim mjekësor emergjent dhe të jetë funksional. Pra kjo vizitë që e kemi realizuar apo këto praktika të funksionimit dhe organizimit që i kemi parë nga afër tashme kanë dhënë frytet po rezultatet e para se gjatë diskutimeve që i kemi pasur me këshilltarin e ministrit të shëndetësisë ne tashme kemi pranuar një propozim të organizimit sipas diskutimeve dhe praktikave që kemi parë gjatë kësaj vizite. Vërejtjet apo shqetësimet tona i kemi dhënë qysh në miratimin në parim dhe kemi thanë se gjatë leximit të dytë dhe të punohet shumë pasi që pjesa e organizimit të këtij shërbimi nuk ka qenë mirë e prezantuar dhe ne kemi thënë se duhet të përgatisim një projektligj i cili është funksional dhe i përmbushë nevojat e qytetareve në marrjen e këtij shërbimi pra të përmbush misionin të cilin i takon. Kurse propozimin që e kemi para nesh dhe në qoftë se do ta kemi mbështetjen edhe të kryeministrit, ministrit të shëndetësisë dhe ministrit të financave pasi që ky propozim do të ketë implikime buxhetore mirëpo është një propozim i mirë dhe në mënyrë të tillë të organizimit të shërbimit mjekësor emergjent do të kryej misionin e vete në ofrim të shërbimeve. Njëkohësisht është edhe sukses i komisionit që nuk jemi ngutë me procedimin e tij por kemi punuar mjaft me qellim që të jetë një ligj funksional dhe të reflektoj ndryshimet e nevojshme në shëndetësi. Ju faleminderit!

Kryetarja – po ju informojmë se takimin me Kryeministrin z. Mustafa dhe me Ministrin e Shëndetësisë z. Rrahmani do të realizohet nesër me dt: 21.04.2016, ora 13:00. Ku do të diskutohet për këtë projektligj për ndryshimet që janë bere dhe do te bëhen, besojmë se punët po ecin shpejt edhe ky projektligj do te procedohet për miratim ne seance.

3. Raportimi i ekspertit për përgatitjen e dokumenteve për nismën ligjore, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 / L - 054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre;

Kryetarja – atëherë po kalojmë të pika raportimi i ekspertit për përgatitjen e dokumenteve për nismën ligjore, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 / L - 054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Pra siç e dini ne kemi marre iniciativën për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji për arsye se disa kategori apo personalitete të cilat janë shpallur edhe Hero të Kosovës në mesin e tyre Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha, Isuf Gërvalla e tjerë afërsisht 245 dhe 250 invalid të kohërave prej vitit 1956 e tutje të cilët humben jetën duke qenë në protesta në burgje apo rrethana tjera duke kërkuar që Kosova të Shpallet Republike dhe një status ndryshe nga ajo që e kishte. Ne konsiderojmë se është e pa drejtë që të shpallesh Hero të Popullit dhe ai të mos ketë bazë ligjore apo statusin e rregulluar andaj për këtë arsye kemi marre iniciativën për plotësimin e këtij ligji. Pra ne kemi angazhuar edhe ekspertin i cili do të raportoj se ku ka mbërrirë me përgatitjen e dokumenteve pasi që kërkesa jonë ka qenë e qartë pasi që ne kemi qenë edhe në kontakt me familjaret e këtyre personaliteteve. Urdhëroni z. Ujkani, prezantoni atë që ku keni arritur deri me tani me përgatitjen e plotësim ndryshimit të ligjit.

Emrush Ujkani, Ekspert i angazhuar nga ana e Komisionit për përgatitjen e projektligjit si dhe Memorandumit Shpjegues për plotësim ndryshimin e ligjit. Faleminderit. E nderuara kryetare të nderuar deputet. Fillimisht ju falënderoj për besimin që me keni dhënë për tu marrë dhe për të trajtuar një çështje që mendoj se është privilegj me tepër është përgjegjësi. Pra për të rregulluar një çështje në aspektin ligjor ashtu siç potencuat edhe ju një kategori statusi i secilës nuk është i rregulluar me ligjin në fuqi. Konformë mandatit sipas vendimit të komisionit dhe termave të referencës kam vazhduar që të punoj në këtë çështje ku jam fokusuar në dy shtylla, e para duke trajtuar këtë çështje në aspektin krahasimor nga vendet e rajonit paka a shumë kanë kaluar nëse mund të themi krahura sikurse kemi kaluar neve, sa kemi vërejtur këto praktika kjo kategori mbrohet me ligj. Kosova e ka pasur situatën pa ma ndryshe duke mos e pasur statusin e Republikës për të cilën kjo kategori edhe ka luftuar apo e ka kërkuar një gjë të tillë. Aspektin tjetër ku jam fokusuar janë definicionet e këtyre kategorive, ku në takimin që keni pasur me përfaqësuesit e këtyre familjareve unë kam qenë prezent vetëm në cilësinë e vëzhguesit kur është folur për këtë çështje, në kemi punuar edhe në kategorizimin e këtyre kategorive, si ushtareve të vrare në armatën jugosllave, invalidëve të cilët kanë pësuar gjatë këtyre protestave, kurse sa i përket periudhës ne nuk jemi marrë shumë me këtë çështje pasi që kjo ka me tepër është çështje politike në këtë rast besoj se komisioni do të vendos për një gjë të tillë se prej cilës periudhe do të ju njehet statuse këtyre kategorive. Çështje të jetë të cilën jemi marrë ka qenë edhe çështja e komisionit qeveritar i cili do ti shqyrtoje statusin e këtyre kategorive. Çështje tjetër me rëndësi që jemi marrë është edhe çështja e statusit dhe beneficioneve për këto kategori ne sa i përket statusit i kemi bërë propozimet kurse sa i përket beneficioneve do të jetë pak e vështirë duke u nisur për faktin se kemi një presion nga Fondi Monetar Ndërkombëtar tek beneficionet besoj se bashkërisht do të shqyrtojmë pasi që është diçka e vështirë dhe do të këtë kosto, mirëpo në këtë rast me e rëndësishme është që të definohet statusi i tyre se sa beneficionet, mirëpo ne do ti bëjmë disa propozime mandej ju si komision vendoseni për këtë çështje. Unë kam punuar mjaft në projektligj mirëpo nuk kam arritur që sot të ju prezantoj besoj se shumë shpejt do të ju përcjellim draftin e projektligjit dhe memorandumit shpjegues dhe bashkërisht do ti trajtojmë në grup punues. Këto janë kryesisht ato çështje që janë reflektuar në projektligj. Nëse keni ndonjë pyetje apo çështje jemi të hupur për diskutim.

Kryetarja – faleminderit për raportimin apo punën se ku keni shkuar me përgatitjen e projektligjit. Atëherë kur ti pranojmë draftet do të punojmë dhe do të shohim se çka ka nevojë për të ndryshuar apo plotësuar.

4. Plani i veprimit për monitorimin e Ligjit për Shëndetësi;

Kryetarja – atëherë kalojmë të shqyrtimi i planit veprimit për monitorimin e Ligjit për Shëndetësi, ne pasi që kemi përfunduar monitorimin buxhetor të skemës se ndihmës sociale, tash kemi në planin e punës monitorimin e Ligjit të Shëndetësisë, para jush keni planin e veprimit për monitorimin e këtij ligji i cili është përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Komisioni, pas shqyrtimit të planit të veprimit për monitorimin e Ligjit për Shëndetësi, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet plani i veprimit për monitorimin e Ligjit për Shëndetësi.

5. Të ndryshme

Kryetarja – para jush keni dy hulumtime parlamentare që janë përgatitur, njeri për projektligjin i cili është në shqyrtim pra projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për

aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ky hulumtim është i mirëseardhur për grupin punuese. Sa i përket projektligjeve në procedurë, ne kemi biseduar se do të organizojmë një punëtor dy ditore ku këto dy projektligje të cilat i kemi në procedurë ti përfundojmë pra projektligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara si dhe projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve. Pra të organizojmë një punëtor jashtë kuvendit me qëllim që të punojmë tanë ditën dhe ti përfundojmë këto dy projektligje.

Komisioni, pas diskutimit të idesë për organizimin e punëtorisë për amendamentimin e dy projektligjeve, nxori këtë:

Përfundim

Të mbahet një punëtor dy ditore për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve:

1. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
2. Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve.
3. Punëtorja të organizohet me datë: 25-26 Prill 2016, në Hotel Sirius-Prishtinë.

Grupet punuese të intensifikojnë punën dhe ti përfundojnë sa me shpejt këto dy projektligje dhe në mbledhjen e radhës së komisionit ti miratojmë propozim amendamentet.

Kryetarja – a ka dikush diçka tjetër të shtoj apo ndonjë çështje tjetër ?

Njomza Emini – faleminderit kryetare. Pasi që në programin legjislativ të Qeverisë është Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili pritet që shumë shpejt të vijë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Unë propozoj që ne si komision se bashku me Komisionin për të drejtat e njeriut të formojmë një grup punues dhe të amendamentojmë bashkërisht këtë projektligj pasi që hynë në fushëveprimin e të dy komisioneve tona dhe pasi që është një projektligj i rëndësishëm se veçante dhe rregullon mbrojtjen e fëmijëve. Unë kam pasur një takim me drejtoreshën e UNICEF dhe sipas saj dhe informatave të tyre çështja e abuzimit të fëmijëve në Kosovë është shqetësuese. Pra të formojmë një grup punues të përbashkët dhe të amendamentojmë këtë projektligj.

Kryetarja – Unë pajtohem me këtë propozim dhe duhet të diskutojmë me kryetaren e komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinor, për personat e pagjetur dhe peticione znj Lirije Kajtazi

Komisioni, pas shqyrtimit të idesë për formimin e grupit punues të përbashkët me komisionin për të drejtat e njeriut, barazi gjinor, për personat e pagjetur dhe peticione.

Komisioni vendosi që të diskutohet me kryetaren e komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinor, për personat e pagjetur dhe peticione znj Lirije Kajtazi për formimin e grupit punues të përbashkët për shqyrtimin e projektligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Kryetarja – para jush po ashtu keni hulumtimin për kopshtet sociale të cilin e kemi kërkuar dhe është bërë me ndihmën e KDI-së përmes projektit të financuar nga USAID për hulumtimet parlamentare. Të cilët i falënderojmë për këtë mbështetje. Ne do të analizojmë këtë hulumtim dhe do të adresojmë në të ardhmen.

Kryetarja – a ka dikush diçka tjetër Jo. Atëherë e mbyllim mbledhjen. Ju falënderoj për kontributin tuaj!

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA